



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 1867/prot.
2

Koplik, më 05.08.2024

V E N D I M

NR, 40 DATË 31 / 07 / 2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORE, ARTISTIKE, PROMOVUESE DHE RINORE.

Këshilli bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 31.07.2024, mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin Nr.10 352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", ligjin nr.8480 datë 27.5.1999 "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", VKM-në nr.121 datë 25.02.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr.540" datë 21.12.1992 "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr.1 datë 24.05.2005 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko – kulturor".

VENDOSI

1. Rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistike, promovuese dhe rinore sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Shëndetësisë, Turizmit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 31.07.2024

Vota Pro 15

Vota Kunder 7

Vota Abstenim 3

Zbardhur me datë 02.08.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA E KULTURËS, ARSIMIT, SPORTIT, SHËNDETËSISË,
TURIZMIT DHE RINISË
SEKTORI I KULTURËS, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Nr. 1867 prot.

Koplik, më 15.07.2024

PROJEKT - V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORE, ARTISTIKE, PROMOVUESE DHE RINORE.

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin Nr.10 352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", ligjin nr.8480 datë 27.5.1999 "Për Funkionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", VKM-në nr.121 datë 25.02.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr.540" datë 21.12.1992 "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr.1 datë 24.05.2005 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko – kulturor".

VENDOSI

T'i propozojë Këshillit Bashkiak të miratojë:

1. Rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistike, promovuese dhe rinore sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Sportit, Shëndetësisë, Turizmit dhe Rinisë.



KRYETAR
TONIN MARINAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA E KULTURËS, ARSIMIT, SPORTIT, SHËNDETËSISË, TURIZMIT DHE
RINISË
SEKTORI I KULTURËS, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Nr. 1867 / Prot.
11

Koplik, me: 15.07.2024

RELACION

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORE, ARTISTIKE, PROMOVUESE DHE RINORE.

Të nderuar këshilltarë,

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin Nr.10 352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", ligjin nr.8480 datë 27.5.1999 "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", VKM-në nr.121 datë 25.02.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr.540" datë 21.12.1992 "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr.1 datë 24.05.2005 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko – kulturor", propozojmë miratimin e "Rregullore për Financimin e Projekteve Kulturore, Artistike, Promovuese dhe Rinore".

Bashkia Malësi e Madhe me anë të kësaj rregulloreje përcakton kriteret, rregullat dhe mënyrat e mbështetjes dhe financimit të aktiviteteve kulturore, artistike, promovuese dhe rinore, rregulla të cilat duhet të plotësohen nga subjektet, shoqatat, apo individët e fushave përkatëse në mënyrë që të përfitojnë mbështetjen e bashkisë Malësi e Madhe, mbështetja financiare do të kryhet në përputhje me projektet dhe fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga bashkia Malësi e Madhe sipas miratimit nga Këshilli Bashkiak të buxhetit të vitit përkatës.

Në rregullore është përcaktuar qartë kush mund të aplikojë dhe çfarë dokumentesh duhet të dorëzojnë aplikantët, gjithashtu edhe rolin, përgjegjësinë dhe kordinimin e punës mes Drejtorisë së Kulturës dhe Këshillit Artistiko-Kulturor.

Drejtorja e Kulturës shpall hapjen e ftesës për pjesëmarrje në realizimin e projekteve specifike të caktuara në fushën e saj, përcakton qartë zërat përbërës të projektit, specifikat e realizimit të tij, si dhe fondet limit që do të përdoren për këto projekte. Ndërsa më pas projekt-propozimet që



vijnë në bazë të ftesës së hapur, Drejtoria e Kulturës i kalon për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Artistiko-Kulturor,
Përmes kësaj rregulloreje Këshilli Artistiko-Kulturor e ka më të qartë rolin dhe përgjegjësinë e tij në këtë proces.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,


KRYETAR
TONIN MARINAJ





**RREGULLORE MBI FINANCIMIN E PROJEKTEVE ARTISTIKE, KULTURORE,
PROMOVUESE DHE RINORE NË BASHKINË MALËSI E MADHE.**

Neni 1
Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve artistike, kulturore, promovuese dhe rinore në bashkinë Malësi e Madhe.

Neni 2
Projektet

Projekt kulturor, artistik, promovues dhe rinor quhet çdo aktivitet që zhvillon vlera për secilën nga fushat: artistike, kulturore, promovuese dhe rinore.

Neni 3
Këshilli Artistiko – Kulturor

1. Këshilli bashkiak me propozim të kryetarit të bashkisë miraton ngritjen e këshillit Artistiko-Kulturor në bashki.
2. Këshilli Artistiko-Kulturor ngrihet dhe funksionon në përputhje me VKM nr.540 datë 21.12.1992, ndryshuar me VKM nr.121 datë 25.02.2005 “Për Krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre” si dhe me udhëzimin nr.1 datë 24.05.2005 të Ministrisë të Kulturës dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko-Kulturor”.
3. Anëtarët e Këshillit Artistiko-Kulturor që në mbledhjen e parë zgjedhin kryetarin dhe sekretarin e këtij këshilli.

Neni 4
Mbështetja nga ana e bashkisë

1. Mbështetja e bashkisë Malësi e Madhe për projekte kulturore, artistike, promovuese dhe rinore, të paraqitura nga persona fizikë e juridikë si dhe nga individë-shtetas shqiptarë, në fushat e artit, kulturës dhe rinisë që kontribuojnë në zhvillimin e vlerave artistike, kulturore, promovuese dhe rinore për këto fusha, jepet në një nga format e mëposhtme:
 - a) Me dhënien në përdorim të ambienteve që administrohen nga bashkia ose nga institucione në varësi të bashkisë si: ambiente të brendshme dhe të jashtme, salla për shfaqje, seminare, ekspozita, panairë libri etj.
 - b) Me mjete financiare, në formën e financimit.





2. Mbështetja financiare do të kryhet në përputhje me projektet dhe fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga bashkia Malësi e Madhe sipas miratimit nga Këshilli Bashkiak të buxhetit të vitit përkatës.

Neni 5 Aplikimi


1. Të drejtën për të aplikuar për financim të projekteve e ka:
 - a) Çdo person fizik / juridik i regjistruar që ushtron veprimtarinë në një nga fushat: artistike, kulturore dhe rinore.
 - b) Çdo individ-shtetas shqiptar
2. Aplikimi për financim të projekteve paraqitet në formën sipas formularit tip bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Neni 6 Dokumentacioni për aplikim

Aplikanti, bashkëngjitur formularit, duhet të paraqesë pranë bashkisë Malësi e Madhe, në dy kopje origjinale dokumentacionin sipas rastit:

1. **Në rastin kur aplikanti është i regjistruar si person fizik ose juridik:**
 - a) Përshkrim i detajuar i projektit në mënyrë të tillë që të krijojë idenë e plotë për llojin e aktivitetit, përmbajtjen, grupmoshat që mbulon, organizimin, qëllimin dhe veçanërisht vlerat që mendohet të sjellë.
 - b) Preventivin e përgjithshëm të shpenzimeve për realizimin e projektit, i detajuar dhe i saktë, ku të prezantohen edhe:
 - 1 – Burime të tjera financiare që mbështesin financimin e projektit.
 - 2 – Mbështetja financiare që kërkohet nga bashkia Malësi e Madhe.
 - c) Informacion për projektet e mëparshme për ata aplikantë që kanë përfituar financim dhe herë të tjera nga bashkia Malësi e Madhe.
 - d) Kërkesa për mbështetje financiare (arsyet pse kërkohet kjo mbështetje nga Bashkia Malësi e Madhe);
 - e) Dokumentat përkatëse që vërtetojnë formën juridike të regjistrimit të aplikuesit si: vendim gjykate/ ekstrakt nga QKB, Nipt të përditësuar dhe CV te subjektit aplikues.
 - f) Kopje të licensës/ve
 - g) Vërtetim që nuk është në proces falimentimi/likuidimi ose që është me status aktiv;
 - h) Vërtetim që nuk ka detyrime të papaguara nga e-albania;
 - i) Nr. IBAN & Llogari Bankare pranë një banke të nivelit të dytë. Llogaria duhet të jetë në lekë e lëshuar nga Banka me firmë dhe vulë origjinale.





k) Deklaratë për zbatimin e të drejtës së autorit

2. Në rastin kur aplikanti është i regjistruar si (Shoqatë, Qendra, Fondacione, OJF)

- a) Përshkrim i detajuar i projektit në mënyrë të tillë që të krijojë idenë e plotë për llojin e aktivitetit, përmbajtjen, grupmoshat që mbulon, organizimin, qëllimin dhe veçanërisht vlerat që mendohet të sjellë.
- b) Preventivin e përgjithshëm të shpenzimeve për realizimin e projektit, idetajuar dhe i saktë, ku të prezantohen edhe:
 - 1 – Burime të tjera financiare që mbështesin financimin e projektit.
 - 2 – Mbështetja financiare që kërkohet nga bashkia Malësi e Madhe.
- c) Informacion për projektet e mëparshme për ata aplikantë që kanë përfituar financim dhe herë të tjera nga bashkia Malësi e Madhe.
- d) Kërkesa për mbështetje financiare (arsyet pse kërkohet kjo mbështetje nga Bashkia Malësi e Madhe);
- e) Dokumentat e subjektit aplikues (vendim gjykate, statut, akt-themelimi dhe Nipt të përditësuar dhe CV te subjektit aplikues).
- f) Kopje të licensës/ve
- g) Vërtetim që nuk është në proces falimentimi/likuidimi ose që është me status aktiv;
- h) Vërtetim që nuk ka detyrime të papaguara nga e-albania;
- i) Nr. IBAN & Llogari Bankare pranë një banke të nivelit të dytë. Llogaria duhet të jetë në lekë e lëshuar nga Banka me firmë dhe vulë origjinale.
- j) Fotokopje e mjetit identifikues (kartë identiteti ose pasaportë)
- k) Deklaratë për zbatimin e të drejtës së autorit

3. Në rastin kur aplikanti është individ

- a) Curriculum vitae – Jetëshkrim
- b) Tre rekomandime me shkrim nga personalitete të shquara ose shoqata të njohura sipas fushës që mbulon projekti për financim.
- c) Përshkrim i detajuar i projektit në mënyrë të tillë që të krijojë idenë e plotë për llojin e aktivitetit, përmbajtjen, grupmoshat që mbulon, organizimin, qëllimin dhe veçanërisht vlerat që mendohet të sjellë.
- d) Preventivin e përgjithshëm të shpenzimeve për realizimin e projektit, idetajuar dhe i saktë, ku të prezantohen edhe:
 - 1 – Burime të tjera financiare që mbështesin financimin e projektit.
 - 2 – Mbështetja financiare që kërkohet nga bashkia Malësi e Madhe.
- e) Informacion për projektet e mëparshme për ata aplikantë që kanë përfituar financim dhe herë të tjera nga bashkia Malësi e Madhe.
- f) Kërkesa për mbështetje financiare (arsyet pse kërkohet kjo mbështetje nga Bashkia Malësi e Madhe)





- lekë e lëshuar nga Banka me firmë dhe vulë origjinale.
- h) Fotokopje e mjetit identifikues (kartë identiteti ose pasaportë)
 - i) Deklaratë për zbatimin e të drejtës së autorit

Neni 7

Procedurat e vlerësimit dhe miratimit për financimin e projektit

1. Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Shëndetësisë, Turizmit dhe Rinisë në bashkinë Malësi e Madhe, shpall hapjen e ftesës për pjesëmarrje në realizimin e projekteve specifike të caktuara në fushën e saj.
2. Në ftesën e hapur përcaktohen qartë zërat përbërës të projektit, specifikat e realizimit të tij, si dhe fondet limit që do të përdoren për këto projekte.
3. Aplikuesi paraqet pranë bashkisë Malësi e Madhe, dokumentacionin e plotë të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.
4. Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Shëndetësisë, Turizmit dhe Rinisë të gjitha projektet e paraqitura së bashku me preventivat e tyre i kalon për vlerësim dhe miratim në Këshillin Artistiko-Kulturor.
5. Këshilli Artistiko-Kulturor i shqyrton projektet, brenda një muaji nga data e dorëzimit nga Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Shëndetësisë, Turizmit dhe Rinisë.
6. Pas miratimit të projektit nga këshilli Artistiko-Kulturor, Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Shëndetësisë, Turizmit dhe Rinisë ka për detyrë ndjekjen e zbatimit të projektit nga subjekti dhe përpilon një raport përfundimtar për kryerjen e projektit si dhe përgatit dokumentacionin për ta përcjellë tek drejtoria e financës për likuidim të shpenzimeve.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA E KULTURËS, ARSIMIT, SPORTIT, SHËNDETËSISË, TURIZMIT DHE RINISË

Data e ardhjes së aplikimit: ____ / ____ / ____

Titulli i Projektit: _____

Aprovohet: Po Jo

Shënime për projektin:

(Specialisti / Drejtori)



Shënim: Kjo faqe plotësohet nga institucioni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

Data me: ___ / ___ / ___

FORMULAR APLIKIMI

PËR MBËSHTETJE TË PJESSHME APO TË PLOTË FINANCIARE (Plotësoni me kujdes këtë Formular Aplikimi, sipas të gjitha udhëzimeve, duke i bashkangjitur edhe projektin e detajuar sipas sqarimeve në faqen e fundit.)

1. Titulli i Projektit: _____

2. Fusha e Projektit: Art _____ Kulturë _____ Tjetër _____

3. Aplikanti: (institucion / organizatë / individ) _____

4. Drejtuesi i Projektit: Emër, mbiemër _____

Adresa: _____

Tel: _____

Nipt: _____

5. Zërat e shpenzimeve që kërkohen të mbështeten nga bashkia:

5.1: _____ Shuma _____ Lekë

5.2: _____ Shuma _____ Lekë

5.3: _____ Shuma _____ Lekë

5.4: _____ Shuma _____ Lekë

5.5: _____ Shuma _____ Lekë

5.6: _____ Shuma _____ Lekë

5.7: _____ Shuma _____ Lekë

5.8: _____ Shuma _____ Lekë

5.9: _____ Shuma _____ Lekë

(Shto më shumë nëse ka)


Total: _____ Lekë

6. Donatorë të tjerë të projektit tuaj. Zëri i shpenzimeve të mbuluara. Shuma e dhuruar

6.1: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____

6.2: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____





- 6.3: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____
6.4: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____
6.5: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____
6.6: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____
(Shto më shumë nëse ka)

Buxheti total i projektit tuaj: _____

7. Objekti dhe Qëllimi i Projektit:

8. Vendi i zbatimit të Projektit :

9. Struktura pritëse e projektit (salla, shesh, etj.):

10. Koha e realizimit të projektit:

Fillimi _____ Kohëzgjatja _____ Mbarimi _____

11. Forma Juridike e Aplikuesit:

12. Nr i llogarisë bankare IBAN Lekë/ e Aplikuesit:

13. Profesioni i Aplikuesit:

14. Institucioni ku punon:

15. Aktiviteti artistik i fushës përkatëse:





16. Tregoni me saktësi mbështetjen nga Bashkia dy vitet e fundit:

16.1: Projekti _____	shuma: _____	data _____
16.2: Projekti _____	shuma: _____	data _____
16.3: Projekti _____	shuma: _____	data _____
16.4: Projekti _____	shuma: _____	data _____
16.5: Projekti _____	shuma: _____	data _____
16.6: Projekti _____	shuma: _____	data _____

(Shto më shumë nëse ka)

17. Bashkangjitur kësaj forme aplikimi do të paraqisni projektin tuaj, i cili duhet të jetë hartuar mbi pikat e mëposhtme:

- Titulli i Projektit. Emri i Institucionit, Organizmit apo Individit aplikues.
- Adresa e plotë e aplikantit dhe funksioni i tij në këtë projekt.
- Qëllimi i projektit.
- Përshkrimi i projektit.
- Cilësoni përfituesit direkt dhe indirekt të projektit tuaj. Përdorni mundësisht statistika për interesin e publikut ndaj projektit tuaj.
- Përshkruani të renë që sjell projekti juaj nga një projekt i ngjashëm me të.
- Përshkrimi i detajuar i projektit. Mundësisht argumentimi i projektit të realizohet me materiale konkrete si psh: të dhëna /statistika mbi impaktin social, materiale të ndryshme vizive apo dokumenta të tjera të nevojshme, që tregojnë rëndësinë e këtij projekti.
- Ekipi dhe burimet njerëzore: Specifikoni emrat, vendin e punës dhe funksionin e secilit pjesëtar të ekipit që do të punojë në këtë projekt.
- Specifikoni burimet dytësore për projektin tuaj në të holla apo shërbime. Si dhe kontratat apo miratimet në parim të donatorëve të tjerë për ndihmën ndaj projektit tuaj.
- Paraqisni formën juridike të grupimit tuaj.
- Tregoni grafikun kohor të realizimit të projektit tuaj. Fillim – kohëzgjatje – mbarim.
- Ndërtoni dosjen e detajuar të buxhetit të projektit tuaj. Pagesat e sakta të ekipit të këtij projekti si dhe përdorimin e të ardhurave nga ky aktivitet nëse ka të tilla.

Projekti nuk duhet të jetë më tepër se 8 faqe.





DEKLARATË E APLIKUESIT

Data me: ___/___/___

Unë _____, në cilësinë e aplikantit dhe njëkohësisht të drejtuesit të Projektit të paraqitur, deklaroj se të gjitha materialet dhe dokumentacionet e bashkangjitura në këtë projekt-propozim janë të vërteta. Në rast financimi të këtij projekti pranoj të gjitha kushtet e kontratës që do të lidhet me Bashkinë, për zhvillimin e projektit.

Emër/mbiemër i aplikantit ose përfaqësuesit të projektit:

Firma ose vula e aplikuesit:

